 - Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta duke dhënë udhëzime porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, të dispozitave përkatëse të kontratave.
 - Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme piketimin e objektit.
 - Të kontrollojë çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.
 - Për çdo punim të maskuar të bëjë fotografimin ose regjistrim e tij dhe të mbaj proces- verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit.
 - Në çdo fund ditë pune të kontrolloj ditarin e punimeve dhe të firmos atë.
 - Të kontrollojë librin e masave i cili vërteton volumin e punimeve dhe ta miratoj atë.
 - Të kontrollojë certifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jap miratimin për vendosjen në objekt të tyre.
 - Gjatë zbatimit të projektit i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit sa herë që e sheh të nevojshme, dhe sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë.
 - Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projektin dhe Preventivin e parashikuar, Mbikëqyrësi i Punimeve duhet t'i paraqesë OSSH sh.a një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga OSSH sh.a.
 - Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqes pranë OSSH sh.a raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e avancimit të punimeve dhe të pagesave të kryera. Realizimi i punimeve në vleftë, përqindje dhe afati kohor i realizimit të financimit.

Raporti Mujor do të ketë këtë përmbajtje:

Mbikëqyrësi i Punimeve duhet të paraqesë një Raport me shkrim mujor pranë Investitorit, i cili do të duhet të përmbajë të paktën:

- Hyrje.
- Informacion i përgjithshëm.
- Të përgjithshme.
- Qëllimi i punimeve.
- Mbikëqyrja e punimeve ndërtimore.
- Personeli i siguruar nga Mbikëqyrësi:
 - Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve.
 - Stafi aktual.
 - Kohëqëndrimi në objekt për secilin.
- Raportimi.
- Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikëqyrjes.
- Përshkrimi i Projektit.
- Organizimi i Sipërmarrësit
 - Stafi prezent.
 - Mjete dhe makineri.
 - Kohëqëndrimi në objekt.
- Progresi Mujor.
- Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave).
- Fotografi të proceseve të punimeve të kryera.
- Fotografi të punimeve të maskuara për çdo punim të padukshëm.
- Grafiku i ecurisë së punimeve:
 - Të aprovuara.
 - Të kryera.
- Volumet Progresive të Punimeve Mujore:
 - Punimet e aprovuara.
 - Çertifikatat e cilësisë dhe Provat Laboratorike.
 - Libreza e Masave.
 - Punimet e kryera por të pa aprovuara.
 - Situacionet mujore.
 - Matjet topografike.
- Korrespondeca:
 - Proces-Verbale.
 - Urdhëra, udhëzime, njoftime.
 - Ndryshime në Projekt dhe Preventiv nëse ka (të aprovuara nga OSSH sh.a).
- Moti (kalendarik).
- Problemet që kanë dalë:
 - Teknike.
 - Sociale.
- → Konkluzione.

Gjatë periudhës së garancisë së defekteve, në përputhje me pikën 1-d, 1-dh neni 27 të VKM-së nr.610/2022 “Përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit,

detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, mbikëqyrësi përgatit udhëzimet për mirëmbajtjen dhe kujdesin e objektit për kohën deri në marrjen e çertifikatës së përdorimit (Procesverbali i marrjes përfundimtare në dorëzim).

Shënim:

- Raporti mujor dhe dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe dhe të dorëzohen në OSSH sh.a
- Raporti mujor do t'i dorëzohet brënda datës së caktuar në kontratë.
- Mbikëqyrësi do të mbajë kontakte të vazhdueshme me OSSH sh.a dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.

Mbikëqyrësi mban përgjegjësi të plotë:

Në fillim të punimeve mbikëqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm:

- Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike.
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet.
- Realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike.
- Saktësinë e vërtetësisë së dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.
- Për realizimin pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis sipërmarrësit dhe OSSH sh.a dhe të gjitha fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.
- Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit.
- Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën
- Urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës
- Ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që i kanë diktuar këto ndërprerje
- Relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit
- Si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.

Për dorëzimin e gjithë dokumentacionit që disponon në rast se gjatë zbatimit të kontratës kemi ndërrim të mbikëqyrësit, i gjithë dokumentacioni dorëzohet me proces verbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi.

Mbikëqyrësi ka të drejtë:

- Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të vecantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.

-
- Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor, n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
 - Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
 - Të mos lejoj vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësoj ato me materiale të tjera nga sipërmarrësi me shpenzimet e tij.
 - Të kërkojë çertifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materiale.
 - Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.
 - Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurt dhe cilësore.
 - Të mos lejoj përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike.
 - Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi, këto duhet të dokumentohen me proces-verbalet e analizave të provave së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit.
 - Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve në rrugë kontraktuale.
 - Mbikëqyrësi i punimeve urdhëron sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në projekt dhe specifikimet teknike.
 - Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për çdo rast me miratimin e OSSH sh.a për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas shkakut, mbikëqyrësi së bashku me OSSH sh.a dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
 - Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht OSSH sh.a për gjendjen e tij.
 - Për çdo ndryshim të mundshëm mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

Në përfundim të punimeve mbikëqyrësi:

- Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve dhe vërteton në proces-verbal datën e përfundimit të tyre sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e të kushteve të kontratës dhe brenda 30 ditëve merr prej sipërmarrësit dokumentacionin përkatës.
- Duke u mbështetur në Ligjin nr.8402/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, VKM nr.2/2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe Udhëzimit nr.3/2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, dorëzon pranë OSSH sh.a të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë, vërtetësinë e tij. Ky dokumentacion duhet të përmbajë:
 - Proces-verbal i dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
 - Proces-verbal për fillimin e punimeve.
 - Kontratën e sipërmarrësit.
 - Kontratën e mbikëqyrjes.
 - Projekt organizimi i punimeve.
 - Projektin.
 - Projektin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korespondencën, skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme.
 - Preventivin fitues.
 - Preventivin e ndryshuar (nëse ka zërat të rinj të punimeve negocimin e tyre).
 - Grafiku i punimeve.
 - Specifikimet teknike.
 - Axhornimi para fillimit të punimeve dhe pikëtimi.
 - Dokumentacioni topografik dhe gjeologo inxhinjerik për ndërtim rrëshqitje.
 - Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi për punimet e padukshme.
 - Proces-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi, të shoqëruar me fotografi.
 - Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikëqyrësi.
 - Libreza e masave.
 - Shkresën e mbikëqyrësit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezerve të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
 - Proces-verbal i përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi.
 - Preventivi i fondit rezervë të firmosur nga sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi.
 - Situacion i fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi.
 - Çertifikatat e cilësisë së materialeve.
 - Miratim i materialeve të përdorura nga mbikëqyrësi.
 - Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar.
 - Regjistri i kontabilitetit.
 - Deklarata teknike e sipërmarrësit e firmosur nga sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik.
 - Njoftimi i sipërmarrësit për përfundimin e punimeve.
 - Proces-verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar.

-
- Relacioni përfundimtar i mbikëqyrësit.

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e tij. Ky dokumentacion është në 3 (tre) kopje. Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudimit që ngrihet me urdhër nga OSSH sh.a brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që i dorëzohen Grupit të Kolaudimit pranë OSSH sh.a duhet të jenë origjinalë.

Mbikëqyrësi i Punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet Grupit të Kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe nënshkruan aktin përkatës. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit i cili i bëhet e ditur sipërmarësit dhe i jepet për të likuiduar OSSH sh.a.

5. KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES

Mbikëqyrja do të jetë për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve dhe për kohën deri në marrjen e certifikatës së përdorimit (periudha e garancisë së defekteve).

6. TË DREJTAT E OSSH sh.a

OSSH sh.a ka të drejtë të kërkojë largimin e mbikëqyrësit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara.
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet.
- Tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara.
- Tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar.
- Tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar.
- Tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike.

Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, OSSH sh.a ka të drejtë të urdhëroj mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjëndjes.

Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III të ligjit nr. 8402/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

7. MËNYRA E DHËNIES SË OFERTËS

Oferta jepet në vlef të totale sipas preventivit bashkëngjitur.

Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertës së tyre duhet ti referohen VKM-së nr.354/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit, projektim, mbikëqyrje

dhe kolaudim”. Gjithashtu dhe udhëzimit të APP-së nr.5585 prot., datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr354/2016” (të cituar dhe më lart).

8. MËNYRA E PAGESËS

Pagesa do të bëhet në bazë të përqindjes së realizimit të punimeve të zbatimit, sipas situacioneve.

LLOGARITJA E FONDIT LIMIT PËR SHËRBIMIN

“Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim për Drejtorinë Rajonale Fier të OSSH sh.a”

1. Supervizion “Daljet e Fiderave nga N/ST Fieri I ri Nr. 2 110/20 kV te cilat do te lidhen unaze me Fiderat e N/ST Fieri I ri 110/20 kV Mbrostar + 1 Fider”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	149,886,964.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	179,864,356.80
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,525,564.99
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,830,677.99
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
2. Supervizion “Rikonstruksioni I rrjetit TM dhe rikonstruksioni I 4 kabinave te mbetura(Verbas 3, Verbas 1, Porteza 10, Qaf Srefan 1) dhe rrjeti TU per Fiderin Pulari 1, Nenstacioni Fieri 1, 35/6 kV”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	50,629,966.13
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	60,755,959.36
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	746,201.67
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	895,442.00
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
3. Supervizion “Rikonstruksioni I rrjetit TM, TU dhe kabinave te Fiderit Pulari 2, Nenstacioni Fieri 1, 35/6 kV”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	70,430,000.36
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	84,516,000.43
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	936,000.15
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,123,200.18
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
4. Supervizion “Rikonstruksioni I rrjetit TM, TU dhe kabinave te Fiderave Kompresori 1 dhe 2, Nenstacioni Patos 35/6 kV”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	104,289,395.12
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	125,147,274.14
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,213,999.52
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,456,799.42
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

5. Supervizion “Rikonstruksioni I rrjetit TM, TU dhe kabinave te Fiderave Oficine, Nenstacioni Patos 35/6 kV”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	78,688,042.21
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	94,425,650.65
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,013,398.46
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,216,078.16
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
6. Supervizion “Rikonstruksioni I rrjetit TU dhe kabinave te fiderit Ngjeqan dhe Roskovec 1 Nenstacioni Matke 35/10 kV”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	61,997,305.04
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	74,396,766.05
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	856,936.33
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,028,323.60
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
7. Supervizion “Zgjatimi I Fiderit Nr. 12, 20 kV kabina Box 13 + shperndarja TU per 13 kabina (Drize+Vadhize)”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	99,958,034.86
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	119,949,641.83
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,184,563.22
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,421,475.86
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

“Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim për Drejtorinë Rajonale Berat të OSSH sh.a”

1. Supervizion “Rikonstruksion I fiderit Potom 10kV TM/TU nestacionin Corovode 35/10kV”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	49,000,308.68
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	58,800,370.42
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	729,115.44
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	874,938.53
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
2. Supervizion “Zhvillimi I rrjetit TU me percjelles ABC,sistemim kabinash ne Fiderin 4B dhe Fiderin 6B N/Stacioni Bicukas 35/10 kV”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	165,989,421.17
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	199,187,305.40
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,650,534.84
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,980,641.80
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
3. Supervizion "Rikonstruksioni i kabinave dhe Rrjetit TU me kabell ABC ne kabinat e Fiderit Nr.29/6KV N/ST Kombinat 35/6KV"	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	90,000,000.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	108,000,000.00
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,109,991.09
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,331,989.30
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
4. Supervizion “Zhvillimi I rrjetit TU me percjelles ABC,sistemim kabinash ne Fiderin 5 N/Stacioni Plasmas 110/ 35/6 kV (Zonat Saver,Bishqethem,Shakuj,Lumth,Gorre,Rrapes,Pirre dhe kamcisht)”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	92,000,000.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	110,400,000.00
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,125,739.76
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,350,887.71
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

5. Supervizion “Zhvillimi i rrjetit TU me percjelles ABC, sistemim kabinash ne Fiderin 8 (6 kV) N/Stacioni Plasmas 110/ 35/6 kV (Saver,Krutje e poshteme,Zhyme,Fieri I Ri,Krutje e Siperme, Gjaze,Ngurrez e Madhe dhe e Vogel dhe Arrez)”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	110,000,001.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	132,000,001.20
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,256,189.95
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,507,427.94
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
6. Supervizion “Zhvillimi i rrjetit TU me kabell ABC,sistemim kabinash ne Fiderin Nr.2(10KV) (18kabina) ,Fideri Nr.3(10KV) (4kabina) dhe Fideri Nr.4(10KV) (12kabina) N/Stacioni Hysgjokaj 35/10KV”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	130,000,002.51
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	156,000,003.01
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,387,695.79
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,665,234.94
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

“Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim për Drejtorinë Rajonale Tiranë të OSSH sh.a”

1. Supervizion “Rikonstruksioni kabinave 20 kV te N/stacioneve Kashar, Qender, Selite, Traktora, Rajonal, Farkë –Tirane”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	198,924,528.40
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	238,709,434.08
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,890,454.81
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	2,268,545.77
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
2. Supervizion “Rikonstruksioni I rrjetit TU me kablllo me vetembajtje ABC ne zonat Rurale te Tiranes ne kabinat e fiderave E5 N/Stacion Farke 110/20/10 kV , Fiderat Gjokaj ,Preze , Vore, Rinas N/Stacion Vore 35/20/6 kV . Fiderat 141 ,150 N/Stacion Valias 35/6 kV Fideri 101 N/Stacion Mezez 35/6 kV”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	149,839,593.80
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	179,807,512.56
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,525,186.21
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,830,223.45
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
II”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	168,637,451.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	202,364,941.20
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,670,362.93
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	2,004,435.52
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
4. Supervizion “Eliminimi i ishujve 6/10 kV dhe kalimi i tyre ne rrjetin 20 kV ne Rajonin Tirane ne N/Stacionet TEC Kombinat 35/6 kV,N/St Dinamo, Vore,Mezez dhe Farke”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	57,073,025.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	68,487,630.00
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	810,587.92
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	972,705.51
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

5. Supervizion “Zhvillimi I kolektorit kabllor ,tunel kabllor per sistemimin e kablllove qe dalin nga nst Rajonal 220/35/20kV”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	99,006,347.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	118,807,616.40
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,177,851.79
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,413,422.15
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

“Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim për Drejtorinë Rajonale Korçë të OSSH sh.a”

1. Supervizion “Zhvillimi i Rrjetit TM 20 kV, Kabina Elektrike, Rrjet TU me ABC Fiderat 8 N/Stacioni Pogradec dhe ndertimi i tubave dhe puseteve per daljet e fiderave 2,3,4,8. (Loti 1)”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	130,361,040.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	156,433,248.00
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,389,795.76
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,667,754.92
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
2. Supervizion “Zhvillimi i rrjetit TM 20 kV, Kabina elektrike, Rrjet TU me përcjellsa me vetmbajtje të tipit ABC, Fiderat 2,3 N.st. Pogradec (Loti II)”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	215,962,793.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	259,155,351.60
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	2,009,998.61
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	2,411,998.33
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
3. Supervizion “Zhvillimi I rrjetit TM 20 kV,kabina elektrike,rrjet TU me ABC Fiderat 4 N.st. Pogradec (Loti 3)”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	116,980,553.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	140,376,663.60
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,305,475.98
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,566,571.18
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

“Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim për Drejtorinë Rajonale Elbasan të OSSH sh.a”

1. Supervizion “Rikonstrukcion I rrjetit TU me kabell ABC dhe I kabinave ne rrethinat e Elbasanit Loti I”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	139,994,510.32
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	167,993,412.38
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,445,061.40
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,734,073.69
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
2. Supervizion “Rikonstrukcion I rrjetit TU me kabell ABC dhe I kabinave ne rrethinat e Elbasanit Loti II”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	139,995,520.48
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	167,994,624.58
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,445,066.89
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,734,080.26
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
3. Supervizion “Rikonstrukcion I rrjetit TU me kabell ABC dhe I kabinave ne rrethinat e Librazhdit”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	119,982,087.89
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	143,978,505.47
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,325,551.70
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,590,662.04
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

“Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim për Drejtorinë Rajonale Burrel të OSSH sh.a”

1. Supervizion “Rikonstrukcion i rrjetit TM-10KV ,TU 0.4kV me kabell 'A.B.C' ne Njesia Kurbin Drejtoria Rajonale Burrel : Zonat" Fushe Shullaz,Fush Milot,Adriatik”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	130,478,239.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	156,573,886.80
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,390,475.37
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,668,570.44
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
2. Supervizion “Rikonstrukcion i rrjetit TM-10KV ,TU 0.4kV me kabell 'A.B.C' ne Njesia Kurbin Drejtoria Rajonale Burrel " Zona: Thuman”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	116,192,191.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	139,430,629.20
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,300,091.69
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,560,110.03
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
3. Supervizion “Rikonstrukcion i rrjetit TM-10KV ,TU 0.4kV me kabell 'A.B.C' ne Njesia Kurbin Drejtoria Rajonale Burrel " Zona:,Bushnesh,Dukagjin”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	104,175,828.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	125,010,993.60
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,213,250.92
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,455,901.10
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

“Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim për Drejtorinë Rajonale Durrës të OSSH sh.a”

1. Supervizion “Investim ne rrjetin rrjetin TU 20kV N/St Kavaje si dhe Zgjerim rrjeti 20 kV si dhe Ndërtim Kabine Elektrike dhe Ndertim Rrjeti T.U per zonen e Golemit,”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	96,289,850.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	115,547,820.00
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,158,211.74
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,389,854.08
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
2. Supervizion “Zgjerim rrjeti 20 kV , Ndërtim Kabine Elektrike dhe Ndertim Rrjeti T.U per zonen e Nikles N/St 110/20 kV Fushe Kruje”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	71,892,508.02
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	86,271,009.62
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	950,202.24
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,140,242.69
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
kabinve)”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	64,952,381.23
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	77,942,857.48
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	885,651.79
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,062,782.14
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
4. Supervizion “Furnizimi me energji elektrike I Parkut Teknologjik DURANA”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	34,948,828.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	41,938,593.60
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	573,097.07
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	687,716.48
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

“Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim për Drejtorinë Rajonale Vlorë të OSSH sh.a”

1. Supervizion “Zhvillimi i linjes TM 20kV, kabinave elektrike dhe linjat TU me percjellës ABC, për fiderin O4 nga N/Stacioni Orikum 110/35/20kV për furnizimin me energji elektrike të zonës Qytet-Orikum”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	159,796,336.56
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	191,755,603.87
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,603,364.50
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,924,037.40
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
2. Supervizion “Ndertimi i rrjetit TM/TU jashte koperacionit Italian ne zonen e Himares”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	199,747,032.03
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	239,696,438.44
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,896,149.28
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	2,275,379.13
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

“Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim për Drejtorinë Rajonale Shkodër të OSSH sh.a”

1. Supervizion “Ndertim kolektori per spostimin e fiderave dales te N/Stacionit 110/20/10 kV,Lezhe”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	11,950,214.84
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	14,340,257.81
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	264,042.26
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	316,850.71
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
2. Supervizion “Sistemim i segmetit TM te fiderit ekzistues F15 si dhe Fideri I ri 20 kV F 3 N/St 110/20/6 kV Shkodra 2”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	117,000,000.35
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	1,305,608.22
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	746,201.67
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	895,442.00
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
3. Supervizion “Zhvillimi i linjës TM 20kVnga N/Stacioni Velipoje deri në kabinën BOX" 15/F 5 " , mbikalimi i lagunës ,kabinave 20kV dhe rrjetit TU me përcjellës me vetëmbajtje ABC për fiderin F5 N/Stacioni Velipojë 110/20kV”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	204,120,792.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	244,944,950.40
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,926,136.70
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	2,311,364.04
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

“Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim për Drejtorinë Rajonale Kukës të OSSH sh.a”

1. Supervizion “Rikonstruksion rrjeti TU me kabell ABC Cernice”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	24,465,763.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	29,358,915.60
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	444,551.73
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	533,462.08
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
2. Supervizion “Rikonstruksion rrjeti TU me kabell ABC Vranisht dhe ndertim kabine Cenali +Rikonstruksion rrjeti TM/TU Lagje 1,2,3,7.”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	79,486,238.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	95,383,485.60
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,020,615.98
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,224,739.18
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
3. Supervizion “Rikonstruksion rrjeti TU me kabell ABC Terthore”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	98,619,151.00
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	118,342,981.20
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,175,096.10
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,410,115.33
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

“Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim për Drejtorinë Rajonale Gjirokastrë të OSSH sh.a”

1. Supervizion “Zhvillimi i rrjetit TM 20kV, Kabina elektrike dhe rrjet TU me ABC ne zonen Cuke ,Sarande, dhe ndertim kabina te reja, rrjet TU me ABC ne fiderat 3,6,qyteti Sarande”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	129,633,822.81
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	155,560,587.37
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	1,385,555.97
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,662,667.17
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II
2. Supervizion “Rikonsdtruksioni i kabinave dhe TU me ABC ne fiderin e Kardhiqit (ne fshatrat Zhulat, Cepune, Taronine,Fushe Bardhe, Golem, Kolonje, Mendar, Prongji, Labove, Andon Poc, Terbuq Hund kuqe)”	
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË PA TVSH	69,982,066.54
VLERA E NDËRTIMIT NË LEKË ME TVSH	83,978,479.85
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË PA TVSH	931,625.89
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKËQYRJEN NË LEKË ME TVSH	1,117,951.07
TARIFA E MBIKËQYRJES PËR STRUKTURAT E TRANSPORTIT	GRUPI II
TARIFA E SHËRBIMIT TOPOGRAFIK TË MBIKËQYRJES TË PUNIMEVE TË TRANSPORTIT	GRUPI II

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- sipas Shtojcës 10

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** të vlerës së fondit limit **për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron.**

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar"*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20%** të vlerës së fondit të limit **për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim** të lëshuar nga **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, sipas përcaktimit në VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016”.

Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve të zbatimit në ndërtim duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Kategori	Emërtimi i kategorisë
NP-1	Punime gjërmimi në tokë
NP-11	Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedist
NS-8/a	Ndërtime parafabrikat beton arme
NS-18	Punime topogjeodezike

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **stafin mbikëqyrës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) të pajisur me licencë profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim, si më poshtë:

- a. Mbikëqyrësin e ndërtimit
- b. Mbikëqyrësin elektrik
- c. Mbikëqyrësin e mjedisit
- d. Mbikëqyrësin topograf

*** Stafi i kërkuar në pikën 2.3.3 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo i deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune të vlefshme
- Licencë profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim,
- Diplomë
- Librezë pune
- CV

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

***** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.**

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 4 (katër) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve **për muajin e fundit te deklaruar**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **për muajin e fundit te deklaruar**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **për muajin e fundit te deklaruar**.

***** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.**

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/ ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve të vlefshme, për objektin që prokurohet, si më poshtë:

